Pershendetje

Nga nje DRT ne drejtim te nje subjekti, eshte nisur nje leter kujtese si me poshte:

"LETER KUJTESE"

I nderuar tatimpagues,

Mospagimi i këstevë të tatimit mbi fitimin dhe
tatimi i thjeshtuar mbi fitimin neni 114/1

Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin ose kësteve paraprake të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, sipas nenit 30, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, dënohet me gjobë në masën 15 për qind të shumës së këstit për t'u paguar. (Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28 tetor 2015).

Ju lutemi merni masa për pagimin e kësteve të Tatim mbi Fitimin sipas afateve ligjore.

Ju faleminderit për bashkëpunimin,

Inspek.Dvatk _____

Duke qene se na u kerkua interpretimi per kete rast, po parashtrojme nje montim ligjor me konkluzion:

Ne Gjykaten Kushtetuese eshte kerkuar anullimi i nenit 13 per penalizimin dhe mospagimin e paradhenies ne afat, por nuk eshte anulluar, duke mbetur ne fuqi.

Ligji 8438 dt. 28.12.1998
PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT I NDRYSHUAR

Neni 30 Parapagimet

1.Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitimin, **brenda datës 30 mars**, për muajt janar, shkurt dhe mars; **brenda datës 30 qershor**, për muajt prill, maj dhe qershor; **brenda dates 30 shtator**, për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe, **brenda datës 30 dhjetor**, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të paguhen **edhe në baza mujore**, **jo më vonë se data 15 e çdo muaji,**

Ligji 99/2015 datë 23.09.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Neni 13

Pas nenit 114 shtohet neni 114/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 114/1

Mospagimi i kësteve të tatimit mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin

Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin ose kësteve paraprake të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, sipas nenit 30, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, **dënohet me gjobë në masën 15 për qind të shumës së kështit** për t'u paguar.".

NJOFTIM PËR MEDIAN

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në datën 03.03.2016 shqyrtoi çështjen

Kërkues: Shoqata për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut.

Subjekte të interesuara: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave.

Objekti: Shfuqizimi i neneve 5, 7, 11, **13**, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të ligjit nr.99/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga kërkuesja, si dhe prapësimet e paraqitura nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, bazuar në nenet 131/a dhe 134/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- **Shfuqizimin e neneve** 5, 14, 15, 16/4, 17/1, 17/2, 18/ 2 dhe 20 të ligjit nr.99/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".